

**POLICE PER SIGURIMIN E DETYRUESHEM
NGA AKSIDENTET
TË PASAGJERËVE NË TRANSPORTIN PUBLIK**



Nr. Serie: _____

SIGURUESI	DEGA/AGIENCIA	NIPT	Tel/Fax

KONTRAKTUESI / POLICËMBAJTËSI	Adresa	NIPT	Tel/Fax

TË DHËNA PËR AUTOMJETIN

Kategorizimi i automjetit	Nr. i serisë i policës TPL		
Targa	Shasia	Marka /Tipi	Nr. i vendeve

TË SIGURUAR

Pasagjerët në transportin publik Urban / Interurban te licensuar nga Autoritetet Pergjegjese.

MBULIMI NË SIGURIM

Territori i Mbulimit	Republika e Shqipërisë
Mbulimet në sigurim	Shuma e Siguruar
Humbje jete	2,000,000 (dy milionë) lekë
Paaftësi e përhershme	Deri në 4,000,000 (katër milionë) lekë
Paaftësi e përkohshme	Deri në 1,000,000 (një milionë) lekë

PERIUDHA E SIGURIMIT:

Nga data: [] [] [] deri më datë: [] [] []

PRIMI I SIGURIMIT

Primi i sigurimit / Vend të regjistruar	Nr. i vendeve të regjistruara	PRIMI I SHKRUAR

Kjo policë sigurimi lëshohet në bazë të ligjit nr. 32/2021 datë 16.3.2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij

TAKSA MBI PRIMIN E SHKRUAR

I Siguruari në respekt të ligjit nr.9887 date 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" nëpërmjet nënshkrimit të policës sigurimit jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale nga Siguruesi me qëllim përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore si dhe transferimin e tyre tek palë të treta për qëllim të sigurimit.

TOTALI

Nënshkrimi i policëmbajtësit në policën e sigurimit, nënkupton se kushtet e kontratës i janë bërë me dije çdo pasagjeri të siguruar dhe janë pranuar prej tyre.

KONTRAKTUESI / POLICËMBAJTËSI	AGJENTI	
(Emër, Mbiemër, Firmë)	(Emër, Mbiemër, Firmë)	

KUSHTET E PERGJITHSHME

OBJEKTI I SIGURIMIT

Objekt i kësaj kontrate është sigurimi i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik. Ky sigurim mbulon vdekjen dhe dëmtimet trupore të shkaktuara pasagjerit sipas mbulimit të përcaktuar në nenin 19, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Pasagjerë janë personat që udhëtojnë me njërin nga mjetet e transportit të destinuara për transportin publik, pavarësisht nëse kanë blerë një biletë, përfshirë personat që kanë të drejtë të udhëtojnë pa pagesë, si dhe personat të cilët ndodhen në territorin e stacionit, të molit, portit, aeroportit ose pranë mjeteve të transportit, para se të hipin ose janë duke zbritur, të cilët kanë qëllim të udhëtojnë ose që kanë udhëtuar me njërin nga mjetet e transportit, me përjashtim të personave të punësuar në mjetin e transportit. Personat që gjenden në avion, në shkallë ose në kabinë pa autorizimin e pronarit të avionit ose të ekuipazhit, nuk vlerësohen si pasagjerë.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Pronari i mjetit të transportit publik duhet të vendos në një vend të dukshëm të mjetit të transportit publik emrin e shoqërisë së sigurimit të përcaktuar në kontratën e sigurimit, si dhe të drejtën e pasagjerit për të përfituar nga kjo kontratë.
2. Në zbatim të ligjit 32/2021 dhe brenda kufijve të përcaktuar në ligj, ky sigurim mbulon vdekjen dhe dëmtimet trupore të shkaktuara pasagjerit nga apo si pasojë e:
 - a) defekteve teknike që çojnë në humbjen e kontrollit mbi mjetin, defekte të cilat ndodhin jo për faj të pronarit apo drejtuesit të mjetit të transportit urban;
 - b) rënies së objekteve të jashtme mbi mjetin motorik gjatë përdorimit të tij, qëndrimit në stacion apo gjatë qarkullimit;
 - c) dëmtimeve aksidentale të shkaktuara nga grumbullime masive, akte të dhunshme që mund të kenë motiv politik ose social, si atentate, sabotime, akte terroriste, dëmtime, zjarrvënienë të qëllimshme, ngjarje ose shpërthime në objektet e ndryshme që ndodhen jashtë mjetit të transportit publik me kusht që ai të mos jetë pjesëmarrës aktiv në ato ngjarje;
 - d) frenimit të papritur, plasjes së gomës, devijimeve të lëvizjes si rezultat i një shpërthimi apo shmangieje të menjëhershme të detyruar që çon deri në përmbytjen e mjetit të transportit publik;
 - e) shpërthimit që ndodh jashtë mjetit të transportit publik;
 - f) çdo ngjarjeje tjetër që ndodh jo për faj të drejtuesit/pronarit të mjetit të transportit publik dhe nuk mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësishë të pronarit të mjetit.Llogaritja e dëmshpërblimit bëhet sipas Rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të dalë në zbatim të nenit 11 të këtij ligji.
3. Kontrata e sigurimit përfundon në njërin nga këto raste:
 - a) me mbarimin e afatit të mbulimit në sigurim të përcaktuar në kontratën e sigurimit;
 - b) me ndryshimin, përfundimin e qëllimit të përdorimit të mjetit për transport publik pasagjerësh;
 - c) me ndryshimin apo humbjen e qëllimit për të cilin mjete është krijuar.
4. Afati i parashkrimit të palës të tretë të dëmtuar, për kërkimin e dëmshpërblimit nga shoqëria e sigurimit, është 2 vjet nga dita e ndodhjes të aksidentit në bazë të nenit 115, shkronja ç) të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TË TJERA

5. Pasagjeri ose përfituesi ka të drejtë të njoftojnë Rastin e Sigurimit të shoqëria që ka lëshuar kontratën e sigurimit, brenda 10 ditëve kalendarike nga data e ndodhjes së aksidentit ose nga momenti që pala e dëmtuar ka patur mundësi të dërgojë njoftimin.
6. Pasagjeri ose përfituesi ka të drejtë, sipas kushteve të kontratës së sigurimit, të kërkojë të shoqëria e sigurimit me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit, që të paguajë dëmshpërblimin.
7. Shoqëria e sigurimit trajton kërkesën për dëmshpërblim dhe njofton palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit apo për refuzimin e kërkesës për dëmshpërblim, për dëme ndaj personit brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të kërkesës për dëmshpërblim. Pagesa pas trajtimit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimit të dëmshpërblimit bëhet brenda 14 ditëve kalendarike.
8. Në zbatim të nenit 9 dhe nenit 10, pika 10, të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, pas trajtimit dhe marrjes së përgjigjes nga shoqëria e sigurimit/Byroja, pala e dëmtuar që ka pretendime, mund t’i drejtohet gjykatës me padi civile.
9. Bazuar në ligjin nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, kufiri minimal i përgjegjësishë, për çdo pasagjer të mbuluar nga kontrata e sigurimit, është si më poshtë:
 - a) 2 000 000 (dy milionë) lekë në rast vdekjeje;
 - b) 4 000 000 (katër milionë) lekë në rast paafësie të përhershme për punë;
 - c) 1 000 000 (një milion) lekë në rast paafësie të përkohshme për punë dhe trajtimet mjekësore.
10. Të dhënat personale të mbledhura nga kjo kontratë (emri i policës së sigurimit të detyrueshëm) do të përdoren në administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit, përfshirë trajtimin e dëmit, në zbatim të ligjit nr. 32/2021 datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Shoqëria e sigurimit (emri i shoqërisë) realizon transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit apo biznesit sipas specifikimeve të ligjit. Në lidhje me të dhënat personale të mbledhura dhe përpunimin e tyre, klienti ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e aksesit dhe të drejtat e tjera të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).

Verifikoni policën tuaj të sigurimit të pasagjerit në Regjistri Elektronik Online të Shitjeve të Sigurimit të Detyrueshëm Motorik në faqen web të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare www.amf.gov.al ose duke kontaktuar në konsumatori@amf.gov.al.